


# Llogaritë Vjetore sipas Sektorëve Institucionalë, 2020

**Tiranë, më 31 Maj 2023:** Në vitin 2020, vlera e shtuar bruto arriti në 1.444.591 milionë lekë. Në vlerën e shtuar bruto, Sektori i Administratës Publike (S.13) shënoi rritje në terma nominalë me 0,21 %, duke rritur lehtësisht peshën që zë në vlerën e shtuar të ekonomisë nga 10,68 % në vitin 2019, në 11,15 % në vitin 2020.

Spektori jo-Financiar zë 47,11 % të vlerës së shtuar bruto gjithsej dhe shënoi një rënie me 1,55 % në terma nominalë.


Vlera e shtuar bruto gjithsej në terma nominalë u ul me 2,33 %, krahasuar me vitin 2019.

**Fig. 1: Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas sektorëve, 2019-2020**



Kontributi i sektorëve në rënien nominale prej 2,33 % të vlerës së shtuar, paraqitet si më poshtë:

**Fig. 2: Kontributi i sektorëve në rritjen nominale të vlerës së shtuar në pikë përqindje**




Treguesi “Kompensimi i Punonjësve” zë 70,49 % të vlerës së shtuar bruto, nga 70,63 % që zinte në vitin 2019.

Sektori Jo-Financiar (S.11) dhe Sektori i Familjeve (S.14), janë dy sektorët më të mëdhenj në ekonominë e vendit dhe përbëjnë përkatësisht 44,28 % dhe 42,04 % të kompensimit gjithsej të punonjësve.


Sektori Financiar (S.12) dhe Sektori i Institucioneve Jo-fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (S.15) përbëjnë respektivisht 1,46 % dhe 0,56 % të kompensimit të punonjësve gjithsej. Në këta dy sektorë operojnë një numër më i vogël njësisish institucionale.

**Fig. 3: Kompensimi i punonjësve sipas sektorëve institucional, 2016-2020**



Fitimi operativ bruto në raport me vlerën e shtuar bruto zë 28,97 % në vitin 2020 nga 28,79 % që zinte në vitin 2019.

**Fig. 4: Kompensimi i punonjësve përkundrejt fitimit operativ bruto, 2016-2020**



Llogaritë Vjetore Sipas Sektorëve Institucionalë

Tab.1 Llogaritë vjetore sipas sektorëve institucionalë viti 2020

Përdorime						LLOGARITË KORENTE SIPAS ESA2010	Burime						
Sektori IJF në shërbim të familjeve (S.15)	Sektori i Familjeve (S.14)	Sektori i Administratës Publike (S.13)	Sektori Financiar (S.12)	Sektori Jo-financiar (S.11)	Ekonomia Gjithsej (S.1)		Ekonomia Gjithsej (S.1)	Sektori Jo-financiar (S.11)	Sektori Financiar (S.12)	Sektori i Administratës Publike (S.13)	Sektori i Familjeve (S.14)	Sektori IJF në shërbim të familjeve (S.15)	
<b>LLOGARIA E PRODHIMIT</b>													
						<b>P.1</b>	Prodhimi	2.547.509	1.411.837	61.506	213.153	839.623	21.391
7.726	284.468	52.128	27.285	731.310	1.102.918	<b>P.2</b>	Konsumi i ndërmjetëm						
13.665	555.155	161.025	34.220	680.526	1.444.591	<b>B.1g</b>	Vlera e shtuar bruto						
							Taksa minus subvencione mbi produktet	202.840					
						1.647.431	Prodhimi I Brendshëm Bruto (PBB)						
<i>(1) Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) është vlera e shtuar bruto plus taksat minus subvencionet mbi produktet (D21-D31).</i>													
<b>LLOGARIA E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE</b>													
						<b>B.1g/B.1g<sup>(2)</sup></b>	Vlera e shtuar bruto / Prodhimi I Brendshëm Bruto	1.647.431	680.526	34.220	161.025	555.155	13.665
5.730	428.117	118.752	14.826	450.853	1.018.278	<b>D.1</b>	Kompensimi i punonjësve						
						204.015	Taksa mbi produktet						
10	536	257	346	6.734	7.883	<b>D.29</b>	Taksa të tjera mbi prodhimin						
							Subvencione mbi produktet	1.175					
7.924	126.502	42.016	19.049	222.939	418.430	<b>B.2g/B.3g<sup>(3)</sup></b>	Fitimi operativ bruto / Të Ardhura mikse bruto						
<i>(2) Taksat dhe subvencionet nuk mund të shpërndahen sipas sektorëve, prandaj PBB me çmimet e tregut nuk është ndarë sipas sektorëve institucionalë por ndodhet në ekonominë gjithsej S.1.</i>													
<i>(3) Përfshirë të ardhurat mikse bruto për S.14 dhe S.1</i>													

# Metodologjia

## **Përshkrimi i sektorëve institucionalë**

Njësia institucionale është subjekti ekonomik i karakterizuar nga autonomia në vendimmarrje në ushtrimin e funksionit të tij kryesor. Njësia rezidente konsiderohet si përbërëse e njësisë institucionale në territorin ekonomik ku ka qendrën e saj të interesit ekonomik kryesor nëse ka autonomi vendimmarrjeje dhe nëse mban një grup të plotë llogarish ose nëse është në gjendje të përpilojë një grup të plotë llogarish. Për qëllimet e sistemit të llogarive, bazuar në tipin e prodhuesve dhe aktiviteteve e funksioneve të tyre kryesore që diktojnë një sjellje ekonomike të caktuar, njësitë institucionale janë grupuar së bashku në pesë sektorë institucionalë të përbërë nga: Korporatat Jo Financiare, Korporatat Financiare, Qeveria e Përgjithshme, Ekonomitë Familjare dhe Institucionet jo-fitimprurëse që u shërbejnë familjeve. Këto pesë sektorë së bashku përbëjnë ekonominë e përgjithshme dhe çdo sektor mund të jetë i ndarë në nënsektorë.

**S.11 Sektori jo-financiar** përbëhet nga njësitë institucionale të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu dhe aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi i të mirave dhe shërbimeve jo financiare.

**S.12 Sektori financiar** përbëhet nga njësitë institucionale të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhuese tregu, dhe veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi i shërbimeve financiare.

**S.13 Sektori i administratës publike** përbëhet nga njësitë institucionale që janë prodhuese jotregu, prodhimi i të cilave i drejtohet konsumit individual dhe kolektiv, dhe të financuara kryesisht nga pagesat e detyrueshme të bëra nga njësitë që u përkasin sektorëve të tjerë dhe njësitë institucionale të angazhuara kryesisht në rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurive kombëtare.

**S.14 Sektori i familjeve** përbëhet nga individë dhe grupe individësh si konsumatorë dhe si sipërmarrës që prodhojnë mallra tregtare dhe shërbime financiare dhe jofinanciare (prodhues tregu) vetëm nëse, prodhimi i mallrave dhe shërbimeve nuk bëhet nga subjektet e veçanta të trajtuara si kuazi-korporata. Ai përfshin gjithashtu individë apo grupe individësh si prodhues mallrash dhe shërbimesh jofinanciare për konsum final vetjak.

**S.15 Sektori i Institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF)** përbëhet nga institucione jofitimprurëse që janë subjekte të veçanta juridike, që u shërbejnë familjeve dhe që janë prodhues privatë tregu, Burimet kryesore të tyre nxirren nga kontributet vullnetare në para fizike ose në natyrë nga familje në cilësinë e tyre si konsumatorë, nga pagesat e bëra nga administrata publike dhe nga të ardhurat e pasurive.

**Përkufizime të variablave**

**Prodhimi:** Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

**Konsumi ndërmjetës:** Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

**Vlera e shtuar bruto:** Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produktet janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si: Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza dhe taksa doganore mbi importet.

**Subvencione në produkte dhe importe:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësive institucionale rezidente.

**Kompensimi i punonjësve** përkufizohet si shpërblimi total, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i paguan punonjësit në këmbim të punës së kryer nga ky i fundit, gjatë periudhës kontabël. Kompensimi i punonjësve përfshin pagat dhe kontributet sociale të punëdhënësve.

**Fitimi Operativ Bruto / Të ardhurat mikse (B.2g / B.3g)**

**Fitimi Operativ Bruto (B.2g)** është diferenca që mbetet pas zbritjes nga vlera e shtuar (me çmime bazë) të kompensimit të punonjësve dhe i taksave dhe subvencioneve të tjera në prodhim.

Fitimi operativ i të vetëpunësuarve quhet "E ardhur mikse bruto (B.3g)", sepse ajo gjithashtu përmban kompensim për punën e personave të vetëpunësuar dhe anëtarët e familjes së tyre.